



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/03-40308/2018
Kaçanik, 27. 12. 2018

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **XII (Dymbëdhjetë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e VI-të), mbajtur me, 27 Dhjetor 2018. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve sa ka Kuvendi i Komunës, fillimisht në mbledhje ishin 26 anëtarë, ndërkaq, për shkak të disa problemeve të komunikacionit, me vonesë erdhi anëtari, Ahmet Luma, kështu që konstatohet së pjesëmarrës të kësaj mbledhje ishin 27 anëtarë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Nënkrjetari i Komunës- Ylber Bajra, drejtorët e drejtorive komunale (Festim Neziraj, Zahir Doda, Fatmir Loku, Ramadush Osmani, Bahri Selimi dhe Diana Reka), ndërkaq nga zyrtarët komunal ishin: Fatlume Guri-Selimi, Bejtulla Dalloshi dhe Arbnora Kuka.

Nga OSBE, mbledhja u monitorua nga: Faruk Dërmaku dhe Gazmend Murseli.

Mbledhja u monitorua përmes Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës, Makfir Malsiu, Zyrtarë e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, në vazhdim e lexoj listën e anëtarëve të KK emër për emër, kuorumi ekziston, në mbledhje prezentë janë 26 anëtarë, ndërkaq anëtari i 27- Ahmet Luma, për shkak të disa problemeve në komunikacion tani më lajmëroj se do të vonohet pak. Në vazhdim e hap mbledhjen e XII (Dymbëdhjetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2018, data 27 Dhjetor, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuar, shkollave të komunës;
3. Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2019;
4. Plani i Punës së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi (KKS) për vitin 2019;
5. Plani i Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2019;
6. Plan i Veprimit për Transparencë, për vitin 2019;
7. Plani i Integritetit të Komunës së Kaçanikut për vitet, 2018-2021;

8. Raport i Shoqatës së Bjeshkatarëve Alpiniste “Kaçaniku 2015” për shpenzimin e mjeteve financiare nga subvencionet; dhe
9. Informatë për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve lokale në Komunën e Kaçanikut.

Pika e 9-të është propozuar në mbledhjen e KPF, materialin për këtë pikë e keni marrë, nëse nuk ka kush diçka atëherë lidhur me Rendin e propozuar i punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë Rendi e propozuar të punës me shtimin e pikës së 9-të shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Rendi i Punës në përbërje prej 9 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes së 11 -të e Rregullt i Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri me një gabim teknik të cilin e paraqiti Ekrem Raka, i cili gabim do të përmirësohet nga Shërbimi i Kuvendit dhe në Faqen Zyrtare të Komunës do të publikohet i përmirësuar. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës, e;

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja e 11 Njëmbëdhjetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës të datës 29 Nëntor 2018/ Lënda: 01Nr. 60/01-37747/2018.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit, konstatoj me kaluar në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave:

Pyetje dhe Kërkesa

z. Shemsedin Luzha, Fillimisht iu uroj Vitin e Ri 2019, qoftë një vit i mbarë dhe i suksesshëm për të gjithë! Në vazhdim e bëri një Njoftim për Kuvendin e Komunës si vijon: Grupi parlamentarë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës(AAK), në përbërje: Shemsedin Luzha, Hajredin Luta dhe Albana Troni, tani e tutje do të vazhdojnë aktivitetin e tyre politik në Kuvendin e Komunës si Grup i Pavarur politik, ndërkaq vazhdojmë koalicionin me Partinë Demokratike të Kosovës (PDK). Këtë njoftim ia kemi adresuar edhe në formë të shkruar Kryesuesit të KK.

z. Afërdita Shehi, E njoftoj Kuvendin e Komunës se unë, Afërdita Shehi kam mbetur anëtare e vetme në subjektin politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovë (AAK), kështu në Kuvendin e Komunës unë do të veproj në opozitë.

z. Arlinda Rakoci-Raka, Fillimisht iu uroj Vitin e Ri 2019, qoftë një vit i mbarë dhe i suksesshëm për të gjithë!

1. Pyetja e parë është për DAK,; Përse nuk futet të ne, mësimi i Gjuhës Angleze në paralelet parashkollore, ashtu si në vendet tjera, kur dihet se kuadër ka komuna jonë.

2. Më intereson të di, përse Ndryshim Plotësimet e Statutit të Komunës nuk po na vijnë në Kuvend të Komunës për shqyrtim, a nuk janë bërë ende ndonjë ujdi, ndërkaq shtoj se, kur

unë kam kërkuar që çështja e ndryshim plotësimeve të Statutit të Komunës të shtyhet për një afat të pacaktuar, nuk jeni pajtuar me propozimin tim.

z. Bekim Koxha, Iu uroj të gjithë qytetarëve të komunës, anëtarëve të KK miratimin e ligjit për FSK, uroj që ky ligj të zbatohet. Gjithashtu uroj për vitin e Ri 2019 të gjithëve që jemi këtu!

Pyetjet:

1. Pyetja e parë është për drejtorinë e DSHPE për çështjen e deponisë në f. Koxhaj; Ku ka ngel Kërkesa, kur dihet se kjo drejtori ka thënë se do të marr veprime të nevojshme për heqjen e asaj deponie.

2. Kryetari i Komunës si po shihet së nuk është prezent në mbledhje, e as drejtori i DUKMM nuk është prezent, ndërkaq pavarësisht mos prezencës, unë po e ngriti një çështje në KK; Unë jam ankuar për një parcelë që iu ka dhënë ETC në qytetin e Kaçanikut, sepse Vendimi për dhënien e saj është i paligjshëm. Për këtë çështje unë kam pasur një takim me Kryetarin e Komunës, Besim Ilazi, në të cilin takim kryetari nuk është sjellë mirë me mua. Unë e kam paralajmëruar kryetarin se lëndën do ta dërgoj në Gjykatë. Edhe pse mendohet se e unë e kam dërguar atë lëndë në gjykatë, ende nuk e kam dërguar. Unë kam qenë kundër miratimit të atij vendimi, pasi ai vendim ka qenë i kundërligjshëm, kur dihet se është kthyer dy herë nga MAPL, ndërkaq për kundër kësaj, drejtorja e Urbanizmit, kompanisë në fjalë-ETC-së, ia ka dhënë Leja e ndërtimit.

z. Ekrem Kyçyku,

1. Në mbledhjen e kaluar të KK unë e pata një Kërkesë për Ekzekutivin e Komunës-Kryetarin dhe DBPZHR, me iu bërë një Kërkesë nivelit qendror për çështjen e mbrojtjes së pyjeve, e sidomos të pjesa e Parkut Nacional. Kërkesa ime e njëjtë përsëritet edhe sot në këtë mbledhje.

2. Banorët e Lagjes Topojan dhe Kovaq, kërkojnë të bëhet rregullimi i shtratit të lumit Lepenc, për arsye se lumi kur ka prurje të mëdha të ujit, ua vërshon edhe pronat e tyre në atë pjesë.

3. Kërkesa për kanalin e ujitjes të tregu, kërkesa është në emër të banorëve të lagjes aty, sepse rruga është shkatërruar gjatë punimeve të kanalit, ndërkaq nuk është rregulluar, kështu që kanali i ujitjes është jofunksional. Kërkesa është në emër të qytetarëve të asaj pjese për funksionalizimin e kanalit të ujitjes.

z. Adnan Reka, Përshëndetje të gjithë, shfrytëzoj rastin të iu uroj Festën e Vitit të Ri 2019!

1. Rruga 'Qamil Ilazi' ndonëse ka ndriçim publik që 50 vite dhe është në Zonën e I, pjesën më të madhe të kohës, ndriçimi publik është jofunksional, një natë ka ndriçim pastaj më shumë se një javë nuk ka ndriçim publik dhe ky cikël vazhdon me vite.

2. Është një kërkesë nga banorët e lagjes 'Çaka dhe Zeneli' të fshatit Bob që janë në Zonën II. Përroi që kalon përmes të këtyre dy lagjeve të rregullohet sa më shpejt, për shkak të rrezikut të shembjes së shtëpive nga rrëmbimi i kohë pas kohe i atij përroi.

3. Në Prill është themeluar 'Komisioni për Zgjedhjen e Këshillave Lokale' unë kam pyetur në mbledhjen e VIII, kam pyetur në mbledhjen e X dhe tash prapë po pyes për funksionalizimin e këtij këshilli. Mbase ju edhe mund t'i dini arsyet por nuk doni te tregoni.

Kryesuesi i Kuvendit, Të gjitha Komisionet e formuara nga Kuvendi i Komunës kanë me hartuar Raport me shkrim për aktivitetin e tyre dhe me raportuar para KK. Në emër të Kuvendit të Komunës kërkoj që; Komisionet e KK t'i hartojnë raportet e tyre të punës dhe në mbledhjet vijuese të KK të raportojnë për aktivitetin e tyre të zhvilluar. Çështjen e

Komisionit për formimin e Këshillave të fshatrave e marrë për sipër unë. Komisionet e formuara të KK ende nuk kanë sjellë ndonjë Raport për aktivitetin e tyre të zhvilluar, por shpresoj se në muajin Janar 2019 do t'i sjellin raportet e tyre të punës.

z. Adndan Reka, Komisioni për Zgjedhjen e Këshillave Lokale nuk është mbledhur asnjëherë. Ky Komision ende nuk e ka zgjedhë Kryesuesin e tij.

z. Shpend Krusha,

1. Nga banorët e një lagje të f. Bëgracë, me konkretisht lagjes së rrugës "Qamil Ilazi" - nëse nuk e kam gabim emrin e rrugës, e kam një Kërkesë për ndërtimin e një trafoje elektrike në atë pjesë, sepse është nevojë e asaj lagjeje për me pasur trafo elektrike.

2. Çështja e nënkalimit të shkolla fillore, ky projekt nuk është kryer ende dhe nuk është paraparë as me buxhet, ndërkaq rreziku ekziston në atë pjesë për nxënës dhe për qytetarë tjerë që kalojnë atypari, ndërkaq nëse ndonjë fatkeqësi, atëherë përgjegjësia bie mbi komunën. Veprimet për realizimin e atij projekti duhet me u krye, ndërkaq forma sesi i kryen dikasteri përkatës, unë nuk e di.

3. Një pyetje e kam për çështjen e kamerave të sigurisë, pyetje për DSHPE, pse disa kamera funksionojnë e disa jo. Përgjigja të cilën ma keni dhënë nuk është adekuate, sepse pyetja është bërë këtu publikisht në KK, ndërkaq përgjigja duhet të merret nga organet ekzekutive të komunës, kështu që kjo Kërkesë përsëritet edhe një herë për me na dhënë një përgjigjen e duhur.

znj. Fatijona Kyçyku, Me intereson të di, kur do të bëhet ndriçimi publik në rrugën "Tefik Raka" në Kaçanik, kur dihet fakti se kjo rrugë është periferike dhe është nevojë e qytetarëve të asaj lagjeje me pasur ndriçimin publik?

Kaltrina Tafili, Unë propozoj që në muajin Janar 2019 ,të hynë në rend pune; Informatë për realizimin e Planit vjetor të Zyrës së Prokurimit Publik për vitin 2018.

z. Bekim Koxha, Kërkoj me marrë informatë në detaje lidhur me projektin të shkolla fillore e f. Kovaqec sepse janë bërë do shkelje lidhur me atë projekt. Kompania e ka lënë projektin në gjysmë, ndërkaq mjetet kompanisë i janë paguar nga komuna, e që kujtoj se kjo nuk është në rregull, kjo është shkelje ligjore.

Kryesuesi i Kuvendit, Tërheq vërejtjen që mos të jepen komente, por vetëm Pyetje dhe Kërkesa nëse keni. Të çështja e Komisionit për formimin e Këshillave të fshatrave e marrë për sipër unë, sepse unë kam menduar se ky komision është mbledhur dhe e ka zgjedhë Kryesuesin e tij, ndërkaq për kërkesat tjera, drejtorët e drejtorive i ka evidentuar të njëjtat, përgjigjet besoj do t'i merri nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhjen vijuese. Meqë nuk ka kërkesa të tjera, atëherë kalojmë në pikën e radhës:

2. Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuar, shkollave të komunës;

Kryesuesi i Kuvendit, Në KPF ka pasur Kërkesa që masa drusore e konfiskuar t'iu ndahet familjeve në nevojë, pasi që shkollat janë të furnizuara me lëndë djegëse. Në KPF është kërkuar me ditur sasinë e masës drusore të konfiskuar, shifra është dhënë dhe e njëjta i është përcjellë edhe juve. Nëse ka kush diçka e hap diskutimin:

z. Nexhat Loku, Pasi që shkollat janë të furnizuara me lëndë djegëse, ne GP i PDK-së, jemi pajtuar që drutë e konfiskuar t'iu epën familjeve skamnore, sepse ka familje në varfëri të skajshme, e që vërtetë kanë nevojë për lëndë djegëse.

z. Ekrem Kyçyku, Unë në mbledhjen e KPF kam qenë i pajtimit që, sasia e masës drusore të konfiskuar t'iu ndahen skamnorëve, sepse ka familje që nuk është në gjendje t'i siguroj dru për dimër, kështu që edhe tani e përkrahi propozimin që doli, që drutë e konfiskuar t'iu ndahen familjeve në nevojë.

z. Selim Reka, Ne, në mbledhjen e KPF për me iu ikur keqpërdorimeve dhe që mos të krijohen pakënaqësi tek qytetarët, kemi kërkuar që drutë e konfiskuar të iu ndahen shkollave, kështu që ne grupi parlamentar i LDK e përkrahim Propozim Vendimin e DBPZHR, që drutë e konfiskuar t'iu ndahen shkollave të komunës.

z. Bekim Koxha, Më intereson të di, sa është sasia e druve të konfiskuar ?

Kryesuesi i Kuvendit, Sasia e druve të konfiskuar është 54m³.

z. Ekrem Raka, Në Propozim Vendim sa po e shoh unë, nuk janë shënuar emrat e shkollave përfituese të druve të konfiskuar. Të ekzekutimi i vendimit, duhet të përfshihet edhe drejtorja e Arsimit.

Kryesuesi i Kuvendit, Tani kemi dy Propozime për ndarjen e masës drusore, kështu unë jam i obliguar t'i shtroj në votim Propozimin Vendimin bazë të DBPZHR dhe Propozimin e Nexhat Loku. Atëherë propozimin e z. Nexhat Loku e shtroj në votim për aprovim;

z. Ekrem Raka, Kërkoj që fillimisht të shtrohet në votim Propozim bazë – Propozim Vendimi i DBPZHR, për ndarjen e masës drusore të konfiskuar, shkollave të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, Atëherë, Propozim Vendimin e DBPZHR, që drutë e konfiskuar me iu ndarë shkollave të komunës e shtroj në votim për aprovim; Prezent kur u votua kjo çështje ishin 26 anëtarë. Rezultati i votimit ishte: 6 votë Për, 20 votë Kundër. Ky Propozim Vendim nuk kaloi.

Meqë Propozimi bazë nuk kaloi, atëherë, Propozimin e z. Nexhat Loku që masën drusore të konfiskuar me iu ndarë familjeve skamnore, e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me, 20 votë Për, 6 votë Kundër. **Në bazë të këtij rezultati, del konstatimi së Kuvendi i Komunës, ndarjen e masës drusore të konfiskuar ua ndërroj destinimin e tyre, e jo siç u miratua kjo pikë në rendin e punës.** Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për ndarjen e masës drusore të konfiskuar në vitin 2018, familjeve skamnore.

3. Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Lidhur me këtë Plan, unë në një takim i kam ftuar edhe shefat e grupeve parlamentare dhe e kemi konsultuar këtë draft dhe nuk ka pasur ndonjë vërejtje. Gjithashtu Ekzekutivit të Komunës iu kam drejtuar me një Kërkesë për me i sjellë

propozimet që mendojnë se duhet me qenë pjesë e këtij Plani. Dihet se disa pika në Planin e punës janë të rregullta, ndërkaq plani është orientues dhe nuk do të thotë se nuk pëson ndryshime sipas nevojave dhe kërkesave. Nëse ka kush di\ka, këtë çështje e hapi diskutimin:

z. Nexhat Loku, Propozoj që në Planin e punës së KK për vitin 2019, të hynë në rend pune për diskutim: Raporti i Punës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2018, në mbledhjet Janar-Mars 2019, sepse si rezultat i mos shqyrtimit të Raportit të auditorit të brendshëm të komunës, dihet se kemi humbur pikën në përfitim të Grantit të performancës së komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, Pajtohem me propozimin e z. Nexhat Loku, Raporti i Auditorit të Brendshëm të hynë për shqyrtim në Planin e punës së KK në periudhën: Janar- Mars 2019, pasi MAPL na ka thënë se kemi humbur pikë në Grantin e performancës, me arsyetim se nuk e kemi shqyrtuar Raportin e Auditorit të brendshëm në KK. Me herët këto raporte janë shqyrtuar në kuadër të Raportit të Kryetarit të Komunës, ndërkaq tani po na thonë me qenë i veçantë ky Raporti i auditorit, kështu po duhet vepruar sipas sugjerimeve që po na jepen.

z. Ekrem Raka, Nga Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2019, duhet të hiqet pika: Plani i Punës së KKSBB për vitin 2019, i caktuar me u shqyrtuar në muajin shkurt 2019, pasi këtë plan pune veç e kemi sot në rend pune. Gjithashtu propozoj që, Mbledhja e 12 e Kuvendit të Komunës të mbahet para datës 24 Dhjetor 2019, për shkak të festave të fund vitit. Përmbyllja e aktiviteteve të punës po bëhet edhe në vende tjera para datës 24 Dhjetor, kjo është e përcaktuar edhe me kalendarin evropian.

Kryesuesi i Kuvendit, Me propozimin e Nexhat Loku që në Plan të Punës së KK të hynë: Raporti i Auditimit të Brendshëm për vitin 2018 dhe propozimet e Ekrem Raka që nga Plani i Punës së KK, të hiqet Plani i Punës së KKSBB për vitin 2019 dhe Mbledhja e 12 të mbahet para datës 24 Dhjetor, e shtroj në votim Planin e Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2019, dhe i njëjti u aprovua njëzëri nga 26 anëtarët e KK sa ishin prezentë kur u votua kjo çështje. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Arovimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2019.

4. Plani i Punës së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi (KKSBB) për vitin 2019;

znj. Kaltrina Tafili, Ky plan pune i KKSBB nuk është gjithëpërfshirës, sepse nuk janë përfshirë të gjitha çështjet të cilat duhet diskutoj ky këshill, si p.sh nuk janë përfshirë shkollat etj. Me një fjalë mund të themi se ky plan pune nuk është gjithëpërfshirës.

z. Ekrem Raka, Disa nga temat e përcaktuara si në Planin e punës së KKSBB dihet se janë të rregullta, ndërkaq ka tema të cilat duhet me i debatuar ky këshill, si çështja e ekstremizmit etj. dhe nuk janë përfshirë në këtë plan. Kjo të jep me kuptuar se ky plan pune nuk është gjithëpërfshirës.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk pati, kështu ky plan pune u shtrua në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 14 votë Për, Kundër ishin 7, Abstenuan 4. Kur u votua kjo çështje, prezent ishin 25 anëtarë. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për aprovimin e Planit të Punës së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi (KKSBB) për vitin 2019.

5. Plani i Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, prezent në këtë mbledhje janë anëtarët e këtij komiteti e edhe Kryesuesi i tij. Nëse ka kush diçka në këtë pikë, e hapi diskutimin:

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka në këtë Plan pune, e hapi diskutimin:

z. Ekrem Raka, Ky Plan pune ka disa gabime gjuhësore të cilat besoj se janë lëshuar jo me qëllim, por si duket plani është hartuar me ngut, kështu është mirë të njëjtat të përmirësohen.

Kryesuesi i Kuvendit, Vërejtjet të cilat i potencoj z. Ekrem Raka janë të arsyshme, edhe ne i kemi vërejtur, bile është mirë Planit t'i bashkangjitet edhe ballina. Diskutime të tjera nuk ka, kështu këtë Plan pune e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Planit të Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2019.

6. Plan i Veprimit për Transparencë, për vitin 2019;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Shpend Krusha, Sot mediat, Websajt janë të kohës moderne dhe mundësi të mëdha për publikim të aktiviteteve të komunës. Të pika 14 dhe 15 e Planit të veprimit për transparencë shënohen përgjegjësitë e Zyrës së Prokurimit lidhur për publikimin e për kontrata, njoftime për dhënie të kontratave, njoftime për konkurse të projekteve, njoftim për anulime dhe njoftim për vazhdim të afatit, personat përgjegjës për publikim e tyre. Ndërkaq të pika e 14, shënohen përgjegjësitë e Zyrës së personelit për publikim në faqen zyrtare dhe mediat e shkruara konkurset, njoftimet për përzgjedhje të kandidatëve, anulim të konkurseve, vazhdim, avancime brenda institucionet, ndërkaq këto nuk janë të publikuara. Unë e kam shikuar Websajtin komunës më herët edhe dje dhe nuk kam parë së ka të publikuara; procedurat e prokurimit e as procedura të punësimeve, çështje këto më të rëndësishme të cilat duhet të bëhen transparente për qytetarët e komunës.

z. Adnan Reka, Meqë jemi të transparenca dhe të gjithë atë po pretendojmë, për të qenë edhe më transparent ndaj qytetarëve, kërkojmë që mbledhjet e Kuvendit dhe të Komiteteve përkatëse të emitohen në kohë reale, apo 'live streaming' si dhe në web-faqen zyrtare të komunës të krijohet një vegël 'link' ku qytetarët do të mund t'i adresonin shqetësimet dhe ankesat e tyre më lehtë.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, kështu këtë Plan e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për, 5 votë ishin Kundër, Abstenoj Ekrem Raka, ndërkaq anëtarët, Shemsedin Luzha dhe Ahmet Luma nuk ishin prezent kur u votua kjo çështje. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Aprovimin e Planit të Veprimit për Transparencë, për vitin 2019.

7. Plani i Integritetit të Komunës së Kaçanikut për vitet, 2018-2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, është një material të cilin komunat tjera e kanë, ky plan ka të bëjë me ndalimin e keqperdorimeve, si korrupsioni etj. nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Kyçyku, Ky Plan është shumë voluminoz në njërën anë, ndërkaq në anën tjetër shihet së nuk janë futur të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ndalimin e dukuritë negative që e dëmtojnë komunën.

z. Bekim Koxha, Në Plan shihet se janë shkruar shumë çështje lidhur me ndalimin e dukurive negative që dëmtojnë komunën, si; si korrupsion, nepotizëm etj. ndërkaq çështja është sa do të jetë i zbatueshëm ky plan.

Kryesuesi i Kuvendit, Se pari të miratoj këtë Plan, pastaj e shikojmë sesa po zbatohet. Meqë nuk ka kush diçka, atëherë këtë Plan të Integritetit e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me 24 votë Për, Kundër votë kundër nuk pati, Abstenoj Ekrem Raka, ndërkaq dy anëtarë nuk ishin prezent kur u votua kjo çështje, Ahmet Luma dhe Kadri Krivenjeva. Në sajë të saj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Me të cilin e Aprovoj Planin e Integritetit të Komunës së Kaçanikut për vitet, 2018-2021.

8. Raport i Shoqatës së Bjeshkatarëve Alpiniste “Kaçaniku 2015” për shpenzimin e mjeteve financiare nga subvencionet;

Kryesuesi i Kuvendit, Unë e falenderoj OJQ- Shoqatës së Bjeshkatarëve Alpiniste “Kaçaniku 2015” që ka hartuar këtë Raport për shpenzimeve e mjeteve buxhetore nga subvencionet e buxhetit të komunës. Kjo praktikë mendoj se duhet të zbatohet në të ardhmën edhe nga të gjithë përfituesit tjerë që subvencionohen nga buxheti i komunës, për shpenzimin e mjeteve vbuxhetore. Edhe në KPF e kam potencuar se, kjo OJQ është e para që ka bërë një Raport mbi shpenzimin e mjeteve të cilat ia ka ndarë komuna nga subvencionet. Unë kërkoj nga ekzekutivi i komunës që të kërkoj raporte mbi shpenzimin e mjeteve buxhetore edhe të OJQ tjera dhe ato raporte të sjellën edhe në KK. Përfituesit e subvencioneve sigurisht se i dërgojnë raportet në drejtori, por mirë është të sjellën edhe në KK, sepse kuvendi po i ndan ato mjete buxhetore. Unë e falendoj OJQ në fjalë për këtë informatë, ndërkaq tani e tutje ndoshta do të bëhet si kriter që, përfituesit e subvencioneve

mos të marrin më mjete buxhetore pa sjellë informatë për shpenzimin e mjeteve. Nëse ka kush diçka në këtë pikë, le të urdhëroj. Meqë nuk ka kush diçka, atëherë konstatoj se kjo **Informatë ishte sa për njoftim të Kuvendit të Komunës.**

9. Informatë për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve lokale në Komunën e Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, kjo pikë është kërkuar në mbledhjen e KPF, nëse ka kush diçka e hap diskutimin:


z. Nexhat Loku, Unë e kam kërkuar këtë Raport në mbledhjen e KPF, për me ditur sesi është bërë pastrimi i rrugëve lokale të Komunës së Kaçanikut. Me intereson të di se nga i ka marrë drejtori i DSHPE informatat lidhur me datat 16, 17 dhe 18 për pastrimin e borës në f. Kotlinë, sepse vetëm me datë: 21 dhe 25 është pastruar bora në atë pjesë. Dihet se një kompani nuk ka mundësi me i mbuluar të gjithë territorin e rrugëve lokale të komunës, dihet tereni i shumë rrugëve lokale është kodrinore-malor, sepse nuk ka kapacitete, unë kam propozuar që mirëmbajtja e rrugëve lokale të ndahen në zona për një menaxhim me të mirë.

z. Ekrem Kyçyku, Në rrugën "Mejdi Dalloshi" nuk e di se është intervenuar ndonjëherë në pastrimin e rrugës. Ne banorët e asaj lagjeje sa herë marrim iniciativa dhe e heqim vetë borën. Më intereson të di a ka ndërmend komuna me marrë veprime të nevojshme në këtë sezona dimri për pastrimin e asaj rruge.

z. Ramadush Osmani, Kontrata është me kompaninë për pastrimin e 21 rrugëve në sezonin; dimëror dhe veror. Fokusi është për pastrimin e rrugëve kryesore. Dihet se kompania nuk mund të veprojë në të njëjtën kohë në të gjitha rrugët. Unë e përgëzoj z. Ekrem Kyçyku për iniciativat që i kanë marrë, për pastrimin e rrugës së lagjes së tyre. Me Planin nuk mund të ndërhyjmë në punën e kompanisë. Fokus të veçantë iu japim rrugëve në pjesën malore, si; Gjurgjedell, Kotlinë, Gllloboqicë dhe të Saniteksi, rrugë këto që kërkojnë në ndërkohë marrjen e veprimeve për pastrimin e tyre. Sa i përket trotuareve, mirëmbajtja e tyre është e rregulluar me Rregulloren për shërbime publike se kush duhet t'i mirëmbajë.

Kryesuesi i Kuvendit, Kjo Informatë ishte se për njoftimin e juaj, nëse nuk ka kush diçka, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës u njoftua me; **Aktivitetin e komunës lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve lokale në Komunën e Kaçanikut, përmes Informatës së DSHPE.**

Pasi jemi në fund të vitit, në emër të Kuvendit të Komunës iu uroj festat e fundit vitit, ndërkaq iu njoftoj së në sajë të përmbylljes së aktiviteteve 1 vjeçare të vitit 2018 të Kuvendit të Komunës, është organizuar një Drekë pune, të Restorant "Mani". Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu në ora: 12:00 e konstatoj mbledhjen të përfunduar. Në pjesën e parë të pikës 2 dhe në dy pikët e fundit ishte prezent edhe anëtarë, Ahmet Luma, kështu që konstatohet se, në fund të mbledhjes ishin prezentë 27 anëtarë.

Procesmbajtës
Makfir Malsiu




Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli


 REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA E KACANIKUT OPSTINA KACANIK			
I	Data 27.12.18	Vendi KACANIK	
II	org.	Nipini	Shtojcë
	01	60/01-40850	/

Kuvendit Komunal Kaçanik

Data 27.12. 2018

Njoftim


I nderuari kryesues i kuvendit, i nderuari nënkryetar i komunes, të nderuar kolegë,

Më lejoni te ju njoftoj se nga dje, grupi parlamentar i AAKsë në përbërje Shemsedin Luzha, Albana Troni Lika dhe Hajredin Luta do të vazhdojnë aktivitetin si grup i pavarun politik.

Me të njejtën ju njoftoj se grupi i pavarun vazhdon marrëveshjen për koalicion me Partinë Demokratike në Kaçanik.

Me respekt,

Shemsedin Luzha



Albana Lika



Hajredin Luta



REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 2007);

nga Mbledhja e XII (Dymbëdhjetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës
për vitin 2018, mbajtur me 27 Dhjetor 2018.

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma,
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Shurdhani.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dallosi.....,
11. Nexhat Loku,
12. Shpend Krusha.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Tafili,
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Troni.....,
23. Afërdita Shehi,.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi,
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,.....,